

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
 MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING

Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit DMM Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No. 4382-2/26

Nr. i faqeve Broj. stranica No. pages -09- Data Datum. Date 01.09.2026

PRISHTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/ Departament za Životnu Sredinu/
Department of Environment Protection

DATE/A:	02.09.2026
REFERENC-Ë:	26/4382-2/MMPH
PËR/ZA/TO:	"Koslabor H" Sh.p.k. Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së Znj. Miradije Gërguri, U.D. Drejtore e DMM-së Z. Rizah Muçolli, Udhëheqës i DLEM-së
NGA/OD/FROM:	Përparim Terziu, Zyrtar i Lartë i angazhuar për Biocide
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për korrigjim të gabimit teknik të Lejes për Produkte Biocide "Koslabor H" Sh.p.k. Prishtinë

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën me Nr. Prot. 26/4382-2 datë: 01.09.2026 të operatorit "Koslabor H" Sh.p.k. Prishtinë, për korrigjim të gabimit teknik në Vendimin e Lejes për Produkte Biocide me Nr. Prot. 25/438--2/MMPH, të lëshuar me datë: 31.08.2026 dhe ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/4382-2/MMPH
Datë: 02.09.2026


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016 dt. 21 qershor 2016), Vendimin e Lejes për Produkte Biocide me Nr.Prot.25/438--2/MMPH, nxjerr këtë:

V E N D I M

Korrigjohet gabimi teknik në Vendimin e Lejes për Produkte Biocide me Nr.Prot.25/438--2/MMPH, të kompanisë "Koslabor H" Sh.p.k. Prishtinë.

Në faqen 3 të Vendimit, në tabelën e cila përmban të dhëna për produktet biocide që do të importohen, te renditja në pozicionin me numër 4, është shënuar gabimisht 1000 shishe dhe nuk është cekur forma, ndërsa duhet të jetë 10000 shishe (PET) me trigger.

Korrigjimi bëhet në faqen 3 të Vendimit, si në tabelën në vijim:



Substancia aktive	Produkti	Sasia / forma	Nr. i notifikimit	Cas Numër	Lloji i produktit biocid (PT)
Ethanol	Alkool Etilik i çnatyruar 70% vol 100 ml me trigger	10000 (Shishe PET)	5442/4382/26/KOS	2372-82-9	Dezinfektues PT (01)

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot.26/4382-2 datë: 01.09.2026 të operatorit "Koslabor H" Sh.p.k. Prishtinë, për korrigjim të gabimit teknik në Vendimin e Lejes për Produkte Biocide me Nr.Prot.25/438--2/MMPH, të lëshuar me datë: 31.08.2026 i nxjerrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është përvjedhur një gabim teknik.

Pas rishqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori, MMPH, ka kostatuar se është bërë një lëshim teknik si në vijim: Në faqen 3 të Vendimit, në tabelën e cila përmban të dhëna për produktet biocide që do të importohen, te renditja në pozicionin me numër 4, është shënuar gabimisht 1000 shishe dhe nuk është cekur forma, ndërsa duhet të jetë **10000 shishe (PET) me trigger**.


Andaj, bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor merr Vendim për **korrigjim** të gabimit teknik të Lejes për Produkte Biocide

Pjesa tjetër e Lejes për Produkte Biocide, me Nr.Prot.26/4382-2/MMPH, të lëshuar me datë: 31.08.2026 mbetet e pa ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë në afat 30 ditë nga marrjes së këtij vendimi në Komisionin e ankesave për shqyrtimin e vendimeve lidhur me lejimet në Ministri.



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/438-2/ZSP/ /26 datë: 02.09.2026

Bajram Kafexholli

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- DMM-së;
- Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore;
- AMMK-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së

